

NEWSLETTER

Dhjetor

**“Dhjetori magjik
në Albsig”** ekskluzivisht
për stafin në ngjarjen
më të rëndësishme,
Festa e fundvitit.

**Panairi i Karrierës
në UMT, Një Hap
më Pranë Suksesit
Profesional**

**Një vit si pjesë e
stafit të Shoqërisë së
Sigurimeve Albsig,
ku jeta nuk
është vetëm punë**

**Dëmet Pezull
me numrin më
të vogël vetëm
në Albsig.**

**Albsig Mbështet
Bienalen e
Arkitekturës
që u Mbajt
në Venecia**

**Suksesi përmbyllës
i punës së Shoqërisë
së Sigurimeve Albsig.**

**Albsig sponsorizon
librin “Të Rënë”,
e punonjësve të
Policisë së Shtetit
përgjatë 32 viteve.**

**Trajnim dedikuar
rritjes profesionale
të punonjësve..
“I Love My
Business”, nga
Ermal Mamaqi**



ALBSIG

PJESË E



KASTRATI GROUP

“Magjia” e Ofertave Festive në Albsig.

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.





Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP



“Magjia” e Ofertave Festive në Albsig.

“Buqeta” e ofertave festive në Albsig tashmë është shpalosur. Bonus, ulje çmimesh, dhurata për të gjithë stafin, klientët e saj dhe jo vetëm. Këtë fundvit, e bukura e festave vjen magjishëm në çdo vatër nga Albsig. Siç e do edhe tradita, “zyra virtuale” e Albsig ka shpalosur dhe ofertat e saj për të gjitha produktet që mund të blihen online nga të gjithë shqiptarët, kanë paketa produktesh të përzgjedhura për fillim vitin e ri 2024. Sigurim shëndeti në udhëtim, sigurim shtëpie, sigurim automjeti, sigurim kasko, e shumë kombinime të tjera fantastike për të gjithë ju dhe familjen tuaj. Prenotoni sa më parë një vit të tërë të mbushur plot sigurimet që ju duhen dhe do të përfitoni jo vetëm nga oferta festive me ulje çmimesh e dhurata për të gjithë, por do të përfitoni dhe sigurinë Tuaj në çdo moment. Albsig është pranë të gjithëve me çmimet, ofertat, që ka kaluar çdo kufi, duke shkuar në çdo familje shqiptare. Albsig ju pret jo vetëm “në dyqanin virtual”, por në çdo pikë shitje të autorizuar, si dhe në çdo kohë. Nxitoni të përfitoni nga oferta e Albsig, që zgjat fare pak ditë, por që e kursejnë shumë “buxhetin” e familjes tuaj. Albsig është një vlerë e shtuar, që ju vjen pranë në çdo moment festiv dhe jo vetëm, për t’ju siguruar në çdo hap që koha kërkon.



ALBSIG



“Dhjetori magjik në Albsig” ekskluzivisht për stafin në ngjarjen më të rëndësishme, Festa e fundvitit.

Për të 19-in vit radhazi Albsig, mbajti edicionin e 19-të të “Dhjetorit Magjik”, me kulmin e saj në eventin e organizuar për punonjësit në ambientet e “Continental Hotel” në Vorë. Eventin, i cili ka për qëllim promovimin e punës dhe vlerat e punonjësve, kjo gërshtuar dhe me koncertin modern dhe tradicional. Pa frikë mund të quhet një spektakël që nuk duhet humbur nga asnjë punonjës i Albsig, pjesë e Kastrati Group. Drejtuesit e Albsig kanë bërë bashkë punonjësit e tyre përmes punës, përkushtimit, kontributit të veçantë dhe frymës pozitive për festat e fundvitit. Kjo, si simbolikë e përmbylljes të punës së një viti dhe ristartimit të një viti të ri. Pa frikë mund të shprehemi, se gjatë këtij spektakli nuk ka munguar as çmimi për mirënjohjen e punonjësve të vitit, të cilit këtë vit kanë performuar në standardet e duhura për të përfaqësuar Albsig-un në çdo aspekt. Gjithashtu, Albsig ende vazhdon kontributin e tij për promovimin e punonjësve në çdo njësi dhe departamenti. Në fjalën e tij, CEO i Albsig Z. Muharrem Bardhoci tha: Është një kënaqësi për mua të jem këtu! Më thanë të mos flas me shifra sonte, por dua të them se me këto që po ndodhin në ekonomine botërore sot, me të gjitha ndryshimet teknologjike që po shohim, mendoj që puna e shumë njerëzve të menaxhuar nga ne, del në pah përmes atyre shifrave të fundvitit. Të cilat janë të pashmangshme pa u përmendur, pasi kemi shifrat më të mira në treg.” Albsig është kompania më inovative në tregun e sigurime. Këtë fundvit mbyll me sukses realizimin e planit për vitin 2023, njëkohësisht është dhe lider në treg për Sigurimin Kasko. Siç është bërë traditë, Albsig organizoi festën e fundvitit me stafin dhe të ftuar special duke ju uruar të gjithë klientëve të saj dhe jo vetëm Gezuar Vitin e Ri 2024. Për stafin ishte ideuar një koncert me këngëtarët më të mirë të momentit si: Gena, Orgesa Zaimi, e Arianit Hoxha. Me repertorin e tyre të pasur dhe zgjedhje këngësh nga të gjitha trevat shqiptare, artistët arritën të krijojnë një atmosferë elektrizuese në sallë, duke përmbushur me sukses të gjitha pritshmëritë dhe dëshirat e stafit të Albsig. Një performancë që shënoi kulmin e mbrëmjes dhe la përshtypje të paharrueshme.



Albsig festë ndryshe për Fëmijët e Stafit.

Më 20 Dhjetor, Shoqëria e Sigurimeve Albsig, e cila është pjesë e Kastrati Group, organizoi me përkushtim dhe profesionalizëm festën e fundvitit për fëmijët e stafeve të Albsig, Albsig Jetë dhe Albsig Invest. Ky event u mbajt në ambientet festive të hollit të katit të dytë në Tirana International Airport, ku u krijuan kujtime të veçanta dhe momente festive për të vegjlit, duke sjellë gëzim dhe bashkësi në këtë periudhë festive të vitit. Buzëqeshjet e çiltërsia e fëmijëve, së bashku me atmosferën e krijuar nga lojërat e tyre dhe ndërveprimi me personazhet e animuar si Elfët dhe Babagjyshi, transformuan hollin e katit të dytë të Tirana International Airport në një mjedis tejet festiv dhe tejet të veçantë. Kjo hapësirë priti me dashuri dhe ngrohtësi festën e fundvitit, duke u shndërruar në një fshat turistik magjik për fëmijët e stafit të Albsig. Ky event, i cili tashmë është bërë një traditë e përvitshme, shërben si shenjë falenderimi dhe vlerësimi për çdo anëtar të stafit, duke theksuar ndjenjën e bashkësisë dhe gëzimin e përbashkët në këto festa të veçanta. Për më shumë se dy orë të vegjlit kaluan kohë në ambjentet e aeroportit nën magjinë festive të dritave të fshatit turistik, ideuar enkas për ata. Jo vetëm kaq, por fëmijët e stafit u bënë protagonistët kryesor në spotin e urimit festiv që Albsig realizoi këtë fundvit. Duke vënë fëmijët në rolin kryesor, Albsig shpreh mesazhin se ata janë dhe do të vazhdojnë të jenë pjesa më e rëndësishme dhe qëndrore e komunitetit të saj. Për 19 vjet me radhë, kjo festë ka qenë një traditë e vlerësuar nga Albsig, dhe edicioni i këtij viti ishte veçanërisht i ndryshëm. Edicioni i këtij viti për festën e fundvitit të Albsig ishte i veçantë dhe mbresëlënës, pasi fëmijët patën rastin të shijojnë nga afër magjinë e festave në një fshat festiv të krijuar posaçërisht për ta në ambientet e reja dhe të përshtatura të Tirana International Airport. Shtuar kësaj, fëmijët morën pjesë në një aktivitet të veçantë, ku përmes një shorteu, ata kishin mundësinë t'i shkruanin "Letra Babagjyshit", duke shprehur dëshirat dhe ëndrrat e tyre për dhuratat që ata dëshironin të merrnin gjatë festave. Ky aktivitet jo vetëm që rriti emocionet dhe pritshmëritë e tyre për festat, por gjithashtu theksoi rëndësinë e ëndrrave dhe dëshirave fëmijënore në këtë periudhë të vitit. Këto letra do të mbledheshin së bashku me të gjithë letrat e fëmijëve të stafeve të tjerë në Kastrati Group, për të realizuar dëshirat e tyre nëpërmjet një shorte të veçantë, duke forcuar ndjenjën e bashkësisë dhe solidaritetit në këtë periudhë festive. Ndërkaq, festa e organizuar dhe e ideuar për fëmijët e stafit të Albsig, nuk kishte si të mbyllej ndryshe. Përmes një darke argëtuese, dhuratave, e lodrave të shumëpritura për fëmijët u shpërndanë nga babagjyshi në fund për të mbyllur më së miri festën e fëmijëve në Albsig.

Suksesi përmbyllës i punës së Shoqërisë së Sigurimeve Albsig.

Bilanci i punës 11-mujore në Albsig duket që është mbyllur me sukses. Viti 2023 ka qenë një ndër vitet më të suksesshme për kompaninë e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group. Konkretisht Albsig mbyll 11 - mujin e 2023 në nivel shumë të mirë duke ruajtur raportin e vullnetareve në nivelin 54.55 % me të lartin në treg dhe rritjen më të madhe me veten me 16.34 %. Orientimi i konsumatorëve dhe tregut në tërësi drejt produkteve të sigurimit vullnetar, që në krye të herës ka qenë një prej pikave më të rëndësishme të strategjisë së kompanisë Albsig dhe rezultatet e të dhënave statistikore e japin mjaft mirë këtë hap të rëndësishëm që vetëm Albsig ka ndërmarrë. Sipas bilancit statistikorë të Buletinit të Autoritetit Mbikëqyrjes Financiare, Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group rënditet e dyta në treg me rritjen me të madhe me veten me 16.34 %, ndërkohë që vetë tregu i sigurimeve në këtë periudhë e ka rritjen 8.45%. Nuk mbetet me kaq, Albsig ndryshe nga të gjitha shoqëritë e tregut, sot ka raportin me të lartë për produktet vullnetare 54.55 %, ndërkohë që vetë tregu e ka rritjen 33.69%. Sukseset e Albsig pasojnë njëra-tjetrën dhe për shumë produkte duket se kryeson tregun. Aktualisht, përveç rritjes në treg, shoqëria ka investuar jo vetëm në zgjerimin e gamës së produkteve dhe veçanërisht rritjen cilësisë së shërbimeve ndaj klientëve, por dhe në zgjerimin e prezencës në treg përmes pikave të reja deri në skajet më të largëta të vendit. Krahas zgjerimit dhe modernizimit të shërbimeve në çdo pikë shitjeje, kompania ka investuar dhe në përmirësimin e shërbimeve online. "Albsig On" është platforma online e cila plotëson çdo nevojë të klientëve virtualë. "Bli Online" përmes web-it të Albsig dhe përfiton jo vetëm zbritje çmimesh por dhe bonuse falas. Synimi i Albsig është ofrimi i zgjidhjeve të thjeshta, të cilat mund të përdoren lehtësisht nga klientët në çdo kohë, 24 orë në 7 ditë të javës. Duke analizuar të gjitha portofolet e produkteve që Albsig disponon duket se shumica prej tyre kryesojnë tregun e sigurimeve në tërësi. Bazuar në statistikat e Autoritetit të mbikëqyrjes Financiare Shoqëria e Sigurimeve Albsig rendit e para në produktet Sigurim Kasko, Sigurim Përgjegjësie, Sigurim i Përgjegjësisë së Ndërtuesit dhe Sigurim i Garancive.



Dëmet Pezull me numrin më të vogël vetëm në Albsig.

Albsig ka numrin më të vogël të dëmeve pezull (të papaguara) në 30.11.2023, çfarë e evidenton pagesën në kohë rekord të dëmeve. Dëmet në Albsig kanë një konceptim dhe shqyrtim ndryshë, cdo hap në këtë drejtim është në shërbim të klientit. Sigurimet përveçse një detyrim ligjor, janë një domosdoshmëri për të cilën të gjithë pronarët e automjeteve dhe ato të bizneseve duhet të jenë të ndërgjegjshëm për përfitimet në raste aksidentesh apo dëmtimi të pronës. Sigurimet shikohen si një shërbim, i cili në të shumtën e rasteve ka pak gjasa që të përdoret, megjithatë garanton siguri të plotë për individët dhe bizneset. Si pjesë e strategjisë së ndërgjegjësimit, ALBSIG u vjen në ndihmë klientëve dhe të interesuarve me këshillim gjithëpërfshirës për të gjitha procedurat që kërkohen në raste dëmi dhe ofron asistencë të plotë e të gjithanshme për çdo rrethanë. Nga të dhënat rezulton se shumica e qytetarëve që pësojnë dëme shëndetësore, apo familjarët të cilët mund të kenë humbur të afërmit e tyre në aksidente, nuk i ndjekin vetë procedurat, e cila në fakt do të ishte më e lehtë për ta, por kontaktohen apo kontaktojnë avokatë dhe i besojnë atyre ndjekjen e çështjes. Edhe pse problematike si çështje, ALBSIG i kushton një rëndësi të veçantë ndërtimit të marrëdhënieve të drejtpërdrejta me vetë klientët dhe zgjidhjen e çështjeve pa nevojën e një pale të tretë. ALBSIG veçohet për numrin më të vogël të dëmeve pezull në treg. Aktualisht sot Albsig disponon numrin më të ulët të çështjeve. Janë 243 dosje dëmsh pezull që shumica prej tyre janë për probleme të lidhura me bashkitë apo institucionet e tjera shtetërore. Albsig zë vetëm 3.21% të vlerës së dëmeve të papaguara në 30.11.2023, çfarë evidenton që Albsig paguan në kohë rekord për të gjitha llojet e dëmeve.

Një vit si pjesë e stafit të Shoqërisë së Sigurimeve Albsig, ku jeta nuk është vetëm punë.

Që prej hapjes në Tiranë në vitin 2004, Shoqëria e Sigurimeve Albsig pjesë e Kastrati Grup ka prezantuar për klientët e saj një eksperiencë krejt të re edhe për punonjësit në tregun e sigurimeve një qasje ndryshe. Të punosh me një Shoqëri Sigurimesh shqiptare, me pronar shqiptar për 19 vite me radhë në më shumë se 25 lokacione nëpër gjithë Shqipërinë, të kesh përvojë edhe jashtë trojeve shqiptare po me këtë kompani, është padyshim një shans i pashoq si për rritje profesionale ashtu dhe për financat familjare, e megjithatë përtej aspektit profesional, Albsig është një Shoqëri e vetëdijshme si pak të tjera, se jeta nuk ka përse dhe nuk duhet të jetë vetëm punë. Qasja njerëzore në gjenezën e Albsig njihsohet me kërkesën e punonjësve për një shoqëri e cila, e bazon suksesin e saj mbi parimin "Kolegë të lumtur, Klientë të lumtur, Kompani e lumtur". Filozofia e Albsig, e përmbledhur në sloganin "Vlerat që na bashkojnë!", është një premtim për t'a bërë biznesin dhe mjedisin e punës sa më njerëzor. Dhe për të nxjerrë sa më në pah vlerat njerëzore sot.

Por, ç'do të thotë kjo konkretisht?

Albsig vlerëson mbi të gjitha stafin e saj, origjinalitetin, kreativitetin dhe aftësinë për të menduar out-of-the box. Kështu, çdo punonjës ka sjell në Albsig një paketë unike aftësish dhe talentesh në komunitet, për të ofruar një përvojë të shkëlqyer të klientit si në business-to-client (B2C) ashtu edhe në business-to-business (B2B), në sektorë të ndryshëm ku përfshihen teknologjia, shitja apo shërbimet financiare dhe dëmshpërblimet në kohë rekord.

Përvoja si punonjës i Albsig është një ndërthurje e kushteve më të lakmuara të punës — që përfshijnë standard të lartë për benefitet financiare, një kartë shëndeti për çdo punonjës, me produkte sigurimesh me çmime stafi, në një zyrë në qendër të kryeqytetit dhe promovime të brendshme — me aktivitete të vazhdueshme si nisma, festa dhe në tërësi, një qasje në burimet njerëzore të mirëmenduar për t'i bërë punonjësit të ndihen sa më të vlerësuar dhe të dëgjuar.



Aktiviteti i dedikuar stafit të Shoqërisë së sigurimeve Albsig për vitin 2023...

Në vitin që lamë pas, punonjësit e Albsig kanë qenë pjesë e organizimeve të larmishme në të cilat kanë qenë ata protagonistë të ndryshimeve pozitive, me synim që gjithsecili të ndihej i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm me energjinë unike që i ka sjellë kompanisë. Magjia që bartin udhëtimet është e pakrahasueshme, por kur udhëtimi bëhet me stafin e punës me të cilin kalon çdo ditë, është edhe më mbresëlënëse! Një arratisje nga e përditshmja ishte ajo që na kishte munguar në fundvit në "Albsig", por që u kompesua menjëherë në fillimvit dhe i dha ngjyra ditëve të kolektivit, dhe i bërë ato më të bukura, pasi energjia që merr nga udhëtimet është e patjetrësueshme dhe e pakrahasueshme. Budva ishte vendi që menduam të vizitonim, një nga vendbanimet më të vjetra në Malin e Zi, që spikat për historinë e pasur kulturore, turizmin, bregun kaltërosh dhe padyshim vendet e panumërta që mund të pushosh. Udhëtimi me autobus me të gjithë stafin e vajzave dhe grave të shoqërisë Albsig, Albsig Jetë dhe Albsig Invest, nisi në mëngjes herët. Udhëtimi shkoi shumë mirë. Grupe shoqërie të ndarë i shikoje duke kënduar në autobus. Pasi bëmë dy ndalime, mbërritëm në destinacionin e kërkuar. Qyteti i Budvës së Vjetër është një vendbanim, i cili daton që në periudhën antike. Ka një arkitekturë unike, që është krijuar kur në këto zona sundonin venecianët. Teksa arritëm afër njëres prej kishave, aty pranë në sheshin e Poetëve, qëndronte i ulur një burrë i thinjur, i cili luante në kitarë duke shijuar notat e muzikës që ndërthureshin me zhurmën e valëve të detit. Shijuam si staf momente magjike. Në qytet ndiheshin ditët tipike të pranverës: rrugët e mbushura me vizitorë, ndërsa në ajër ndihej aroma e luleve dhe bimësisë së sapoçelur. Kaltërsia e portit thurej me pasqyrimin e jahteve, anijeve dhe barkave të ankoruara në molin e qytetit. Mbi 10 kisha me një arkitekturë joshëse në Qytetin e Vjetër shpërndanin ngado aromën e temjanit, ku një prej më të bukurave ishte kisha e Shën Mërisë, me një shesh panoramik që sheh brigjeve të Adriatikut, e cila ishte një ndalesë shpirtërore për shumicën e vizitorëve ku bëri pjesë dhe stafi jonë, por edhe për të shkrepur fotografitë më të bukura të këtij udhëtimi. Në mbrëmje zgjodhëm një nga lokalet e qytetit, ku shijuam pijet dhe muzikën e mirë për të mbyllur ditën. Stafi i Albsig.sh.a, Albsig Jetë dhe Albsig Invest - Udhëtim në Mal të Zi me Rastin e 8 Marsit. 07 Dita e nesërme nisi plot energji. "Porto Montenegro" ishte destinacioni i radhës. Një zonë luksoze, të cilën kushdo që shkon në Budva nuk duhet ta lërë pa e parë, sepse ndodhet vetëm 25 kilometra larg. Porto Montenegro konsiderohet si një nga destinacionet më mbresëlënëse të Adriatikut dhe një nga më të mirët në Mesdhe. Ndërtesat dhe hotelet luksoze, shëtitëtorja buzë detit, dyqanet e markave ndërkombëtare, jahtet në zemër të rivierës së Tivarit, bëjnë që gjithkush që shkon aty të shijojë pamjen e mrekullueshme të gjirit të Bokës, i cili mbrohet nga UNESCO. Në kthim nuk kishim si të mos ndalonim për të parë nga afër Shën Stefanin, një nga pikat më të vizituara të qytetit. Dikur një ishull, por tanimë prej vitesh i lidhur me një rrugicë të ngushtë me bregun e detit, duke krijuar në këtë mënyrë një nga pikat më të bukura turistike. Ishulli i Shën Stefanit daton në shekullin e 15-të dhe karakterizohet nga ndërtesat e veçanta prej guri, nga oborre të bukura prej të cilave mund të shijosh në pafundësi pamjen dhe aromën e detit. Këtë udhëtim menduam ta finalizonim me një kafe të vonë në Shirokën e bukur të Shkodrës për ta mbyllur ashtu siç duhej këtë arratisje fantastike, e cila ka për të mbetur gjatë në kujtesën tonë. Ne, në Albsig besojmë se shërbimi i mirë vjen nga marrëdhëniet e forta që krijohen tek ekipi ynë, nga përkushtimi i çdo dite për të dhënë më të mirën dhe nga fryma e përfshirjes dhe solidaritetit me klientët. Që nga dita e parë e punës dhe gjatë gjithë viteve të përvojës, sfidojmë veten për të qenë gjithmonë në lartësinë e duhur, zhvillohemi për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave të çdo klienti, sepse i konsiderojmë si partnerët tanë më të vlefshëm. Vlerat tona na bashkojnë e na bëjnë më të fortë për të përballuar çdo situatë.



Trajnim dedikuar rritjes profesionale të punonjësve. “1 Love My Business”, 2.000 Persona në Trajnimin e Ermal Mamaqit, Pjesëmarrëse dhe Albsig.

Është paraqitur komplet ndryshe, këtë herë në fokus ka qenë biznesi. Ndryshe nga cikli i trajnimeve të mëparshme, duket se pjesëmarrja ka qenë shumë më e madhe. Këtë radhë Ermal Mamaqi e çoi fokusin e trajnimeve të tij tek biznesi dhe rritja në karrierë dhe kur bëhet fjalë për biznes, salla është tejmbushur. Thuhet se rreth 2.000 persona u bënë pjesë e këtij trajnimi 2-ditor në Pallatin e Kongreseve. “Jam shumë i lumtur që edhe në Shqipëri po hapet ‘loja’ e trajnimeve. Nuk ishte e lehtë të mbushje një sallë me 2 mijë e ca vende, për t’i bërë të paguajnë një biletë jo shumë të lirë”, u shpreh Mamaqi. Për të ndarë rrugëtimin dhe sukseset e tij, në eventin “1 Love My Business” i ftuar special ishte biznesmeni i njohur Samir Mane. Të sjellësh elemente unike në treg është një nga këshillat e tij për sipërmarrësit e rinj. “Nuk mund të kem shumë gjëra unike në një biznes, por mjaftohem që të këtë një gjë. Pse gjëja unike do të funksionojë, çfarë gjëje unike ka”, tha Mane. Pjesëmarrësit i përjetuan të gjitha emocionet që ofroi ky trajnim. Ajo çfarë përfitohet mbi të gjitha është motivimi dhe njohuria për të rritur veten profesionalisht. “Fuqia e këtyre trajnimeve funksionon. Nëse do të kesh diçka që nuk e ke, duhet të bëhesh dikush që nuk je dhe që të bëhesh dikush që nuk je, duhet të shkosh në vende që nuk ke qenë, si këto trajnimet e çmendura që njerëzit kërcejnë dhe hidhen, mendojnë, preken, qeshin dhe qajnë”, u shpreh Mamaqi. Pjesë e trajnimit 2-ditor ishin grupmosha të ndryshme, njëkohësisht dhe nga biznese të ndryshme që kanë lënë gjurmë në zhvillimin e ekonomisë në vend. Në trajnim morën pjesë dhe pronar të bizneseve që treguan me detaje historikun e biznesit të tyre dhe dhanë mesazhe të rëndësishme për biznesin e rinj.



Panairi i Karrierës në UMT, me Mbështetjen e Albsig, Një Hap më Pranë Suksesit Profesional

Albsig gjithmonë pranë studentëve. Në prag të mbylljes së një tjetër viti të suksesshëm akademik, Universiteti Metropolitan Tirana organizoi Panairin e Punës dhe Karrierës në muajin Maj. Jo vetëm studentët e UMT, por risia e këtij viti ishte edhe pjesëmarrja e hapur për studentët të institucioneve të tjera të arsimit të lartë në vend. Pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen me tregun e punës për secilin nga fakultetet respektive, pasi të pranishëm në këtë panair ishin rreth 50 biznese më të zë të industrive të ndryshme si ajo e telekomunikacionit, bankare, teknologjike, tregut të sigurimeve, zhvillimet kompjuterike, kompani rekrutimesh por dhe agjenci dhe institucione qeveritare. Ky Panair i Punës dhe i Karrierës, këtë vit u organizua në shenjë të "Dual Studies", nismës më të re të Universitetit Metropolitan Tirana për t'u ofruar studentëve mundësi punësimi gjatë periudhës së studimeve, sipas një procesi të rregulluar. Shoqëria e Sigurimeve Albsig gjithmonë është spikatur si mbështetëse e brezave të rinj në rrugën e karrierës. Kompanitë e pranishme në event ekspozuan ofertat mbi praktikën mësimore, internshipet, mundësitë e punësimit, trajnimet dhe workshop-et. Albsig.sh.a, pjesë e Kastrati Group, ka qenë dhe është gjithmonë e hapur ndaj punëkërkuesve të rinj, me dëshirë për të mësuar dhe për të zhvilluar edhe më tej aftësitë personale dhe profesionale, duke u dhënë hapësirën e kërkuar për të përfituar sadopak eksperiencë në fushën e sigurimeve.

Albsig sponsorizon librin “Të Rënët”, e punonjësve të Policisë Shtetit përgjatë 32 viteve.

 albsig.al

Shoqëria e Sigurimeve Albsig.sh.a ka bërë të mundur sponsorizimin e vëllimit të parë të librit me titull: “Të Rënët”. Vëllimi i parë i këtij libri ka ardhur në dorën e lexuesve vetëm në saj të mbështetjes financiare nga Albsig. Ky libër është shkruar nga Hilë Lushaku dhe Bajram Ibraj dhe është koha më e mirë për të filluar të lexoni mbi kujtimet e jetëve të humbura në radhët e institucioneve ligjzbatuese të Ministrisë së Brendshme përgjatë viteve 1990-2022 në Shqipëri. Ky libër tregon historinë e të rënëve në kye të detyrës në Institucionet ligjzbatuese dhe është lexuar, vlerësuar e marrë parasysh nga audienca çdo detaj i tij i hedhur në letër. Më e rëndësishmja që vlen për tu theksuar është se ky libër, nxjerr në pah historitë rrëqethëse të 422 personave të rënë në detyrë vetëm për periudhën prej 32 vitesh. Jo vetëm kaq por, libri spikat dhe emrat e Dëshmorëve të Atdheut, ku nga 186 të rënë 180 i përkasin Policisë së Shtetit. Libri është hartuar t’ju vij në dorë lexuesve me vëllime. Aktualisht vëllimi i parë është përfunduar dhe përqafur shumë nga lexuesit. Autorët e librit bëjnë më dije se kanë nisur me draftet e vëllimit të dytë të këtij libri. Shoqëria e Sigurimeve Albsig sh.a ka dhënë mbështetje për arsimin, artin kulturën, institucionet publike, shtresat në nevojë, duke financuar dhjetëra aktivitete që janë zhvilluar brenda dhe jashtë vendit. Albsig.sh.a pjesë e Kastrati grup i ka kushtuar përgjegjësisë sociale një vëmendje shumë të madhe. Albsig ka angazhuar burime njerëzore dhe shpenzuar shuma të konsiderueshme, të cilat janë në dispozicion të drejtpërdrejtë të shoqërisë dhe mjedisit ku Albsig ushtron veprimtarinë e saj, por dhe më gjerë, mjedisit kulturor, artistik, mediatik etj. Albsig.sh.a ka mbështetur financiarisht veprimtari të shumta si ekspozita, botime librash, institucionet publike, koncerte muzikore, vepra teatrore, promovim të vlerave kombëtare edhe jashtë vendit, aktivitete sportive, etj. Kjo ka bërë të mundur pikërisht atë mbështetje, atë plotësim të atij dimensionit që biznese të mesme dhe të mëdha janë duke luajtur në drejtim të zhvillimit të artit, kulturës dhe sportit letërsisë. Në arkivat e Albsig numërohen më gjumë se 250 sponsorizime librash të autorëve të rinjë dhe atyre më në zë. Albsig ka qenë dhe do të mbetet promotore dhe mbështetëse e historisë kulturës e letërsisë mbarë shqiptare.



Albsig Mbështet Bienalen e Arkitekturës që u Mbajt në Venecia.

Botime librash, ekspozita të shumta dhe së fundi ka mbështetur dhe Bienalen e Arkitekturës mbajtur në Venecia. Pavijoni shqiptar në Ekspozitën Ndërkombëtare të Arkitekturës në "La Biennale di Venezia" interpreton temën e përgjithshme "Laboratori i së Ardhmes" nëpërmjet ekspozitës "Përsiatje të Pakohë". Kuruar nga Era Merkuri dhe Martin Gjoleka, kjo ekspozitë është realizuar në bashkëpunim me Ani Markun dhe Geraldo Prendushin. Ekspozita vë në pyetje kuptimin e ripërtëritjes të hapësirës publike dhe rolin e arkitektit si agjent ndryshimi. Një odise virtuale, e cila nis me disa vëzhgime në dy hapësira publike në Tiranë, Stadiumin Dinamo dhe Liqenin Artificial - dy zona që po përballen me vështirësitë e kohës, një stadium bosh që nuk përdoret mjaftueshëm dhe tjetra që mbipërdoret. Një ndër mbështetësit e realizimit të këtij eventi kaq të rëndësishëm është edhe Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group. Thirrjes së ministrit të është përgjigjur menjëherë Albsig, e cila është një ndër kompanitë që ka mbështetur dhe mbështet gjithmonë risitë në të gjitha fushat. "Këta arkitektë po sjellin diçka nga ideniteti ynë. Kanë sjellë dy vende, por që mund të jenë një stadium dhe një liqen që mund të jetë kudo në botë. Po studiojnë se cila do të jetë e ardhmja e arkitekturës në kohën e inteligjencës artificiale. Gjithashtu jemi të lumtur që sjellin këtu në Bienale një skuadër arkitektësh të rinj", - tha Margariti. Nëpërmjet ekspozitës, pavijoni i fton vizitorët të mendojnë thellë mbi mundësitë dhe realizimet e ndërlidhjeve ndërmjet njerëzve, mjedisit dhe teknologjisë. Projekti fitues që prezanton vendin tonë në Venecia u përzgjedh nëpërmjet një thirrjeje të hapur për projekt-propozime shpallur nga Ministria e Kulturës në rolin e komisionerit të pavijonit të Shqipërisë, në vijim të dy fazave të procesit selektiv, nga një juri ndërkombëtare e përbërë nga Berina Kokona, Simon Battisti, Eugen Kallfani, Erfort Kuke dhe Arjan Ymeri. Bienalja e Arkitekturës do të jetë e hapur për publikun deri më 26 Nëntor 2023.





Albsig “surprizon” Fëmijët e “Zyber Hallullit” në festën e 1 Qershorit.

Këtë 1 Qershor, Shoqëria Albsig zgjodhi të ishte pranë fëmijëve të shtëpisë së fëmijës “Zyber Hallulli” me dhurata dhe veshje për t’u ardhur sadopak në ndihmë në këtë ditë të veçantë dhe të gëzuar për ta. Albsig mbështet shtëpinë e fëmijës “Zyber Hallulli” në Tiranë, duke bërë të mundur që çdo fëmijë nga klasa e 1-rë deri në klasën e 9-të, në këtë institucion, të mos i mungojnë veshjet verore dhe çdo material tjetër i domosdoshëm për të kaluar sezonin veror. Gjithashtu, përveç materialeve të domosdoshme, veshje e materiale sportive, etj. Shoqëria e Sigurimeve Albsig është një institucion i dedikuar të japë kontributin për shërbimin ndaj komunitetit, veçanërisht në këtë target grup të popullsisë. Albsig e sheh këtë dhurim si përmbushje të përgjegjësisë dhe detyrimeve të tij të përgjegjësisë sociale. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, drejtoresha e marketingut në Albsig, znj. Valbona Dako, duke i uruar suksese fëmijëve për mbylljen e vitin shkollor dhe fillimin e pushimeve verore, u shpreh se Albsig ka qenë gjithmonë pranë fëmijëve të këtij institucioni dhe do të vazhdojë të jetë edhe në të ardhmen. Albsig mbështet Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli” me rastin e festës së 1 Qershorit. “Jam shumë e lumtur që jam sot këtu me ju. Ne jemi kujdesur që edhe këtë vit të mos mungojnë veshjet verore dhe mjetet sportive që ju mund të kaloni pushime të paharruara,”- theksoi Dako. Shoqëria e Sigurimeve Albsig gjithmonë është spikatur si mbështetëse e fëmijëve në të gjitha target grupet e shoqërisë. Albsig.sh.a, pjesë e Kastrati Group, ka qenë dhe është gjithmonë e hapur ndaj kauzës së fëmijëve jetimë, me dëshirë për të mësuar dhe për të zhvilluar edhe më tej aftësitë personale dhe profesionale, duke u dhënë hapësirën e kërkuar për të përfutur sadopak eksperiencë dhe mundësi.



Sport, Albsig, mbështet Turin Ndërkombëtarë të Çiklizmit në Shqipëri




Rrethi Çiklistik i Shqipërisë, i njohur ndryshe si Turi Çiklistik i Shqipërisë, zhvilloi këtë vit edicionin e tij të 80-të. Gara e 3-të më e vjetër çiklistike në Evropë, e cila prej disa vitesh është pjesë e kalendarit ndërkombëtar, ku përshkohen plot 754 km gjatë 5 etapave të saj dhe marrin pjesë 14 skuadra, nga të cilat 11 janë ndërkombëtare, përgjatë itinerarit Tiranë-Lushnjë-Elbasan-Vlorë-Përmet, duke e mbyllur në finishin tradicional të Fierit. Për eventin e realizuar u vendosën në lëvizje të gjitha instancat si shërbimet e Policisë Rrugore, të Patrullave të Përgjithshme dhe të Forcës së Posaçme "Shqiponja", të Drejtorive Vendore të Policisë Tiranë, Elbasan, Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë, në bashkëpunim me organizatorët e kësaj veprimtarie ndërkombëtare, kanë marrë masa për mbarrëvajtjen e saj, sa i përket sigurisë rrugore dhe rendit. Pesë qytetet pjesëmarrëse në garë kanë qenë në gadishmëri me të gjitha masat e duhura për t'i ardhur në ndihmë pjesëmarrësve në garë dhe për të motivuar një event të tillë. Jo vetëm kaq por, me qëllim garantimin e zhvillimit të kësaj veprimtarie dhe për të njoftuar qytetarët që kishin pasur në planifikim lëvizjen në akset rrugore, në datat që do të zhvillohet ky rreth çiklistik, Policia e Shtetit mori masat e duhura për bllokimin dhe devijimin e lëvizjes së automjeteve në akset rrugore ku u zhvillua gara. Ekspertet bëjnë me dije se rrethi i 80-të Çiklistik i Shqipërisë përfshin 5 etapa garash me itinerare të gjata në disa nga akset rrugore kombëtare. Në këtë aktivitet morën pjesë 14 ekipe nga 10 vende të ndryshme të botës dhe afro 100 garues. Rrethi i 80-të Çiklistik i Shqipërisë u nda si më poshtë: Etapa e parë - Tiranë - Dushkë - Krrabë 146 km Etapa e dytë - Tiranë - Lushnjë - Elbasan 157 km Etapa e tretë - Elbasan - Vlorë 143 km Etapa e katërt - Vlorë - Mbrostar - Përmet 185 km Etapa e pestë - Përmet - Fier 123 km Totali: 754 km. Ky event kaq i rëndësishëm, jo vetëm për Federatën e Çiklizmit, por për të gjithë artëdashësit e këtij sporti u mbështetën nga Albsig, pjesë e Kastrati Grup. Shoqëria e Sigurimeve Albsig gjithmonë është spikatur si mbështetëse e eventeve sportive në të gjitha target grupet e shoqërisë. Albsig sh.a. pjesë e Kastrati Group ka qenë dhe është gjithmonë e hapur ndaj sporteve dhe aktiviteteve në ndihmë të mirëqenies së jetës në komunitet.

Apeli i Stafit të Albsig në Ditën Botërore të Dhurimit të Gjakut: “Të gjithë Ne, me aq sa kemi mundësi, të dhurojmë gjak të paktën një herë në vit, sepse me çdo dhurim tonin, Ne shpëtojmë jetë”

Çdo vit më 14 Qershor në shumë vende të botës organizohet “Dita Botërore e Dhurimit të Gjakut” dhe kësaj dite i është bashkuar dhe stafi i Shoqërisë së Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Grup. Mesazhi i kësaj dite thekson kontributin thelbësor që dhuruesit e gjakut japin për të mbajtur botën pulsuese, duke shpëtuar jetë dhe duke përmirësuar shëndetin e të tjerëve. Një fokus i veçantë i fushatës së këtij viti do të jetë roli i të rinjve në sigurimin e një furnizimi të sigurt me gjak. Si në shumë institucione edhe në Albsig, të rinjtë kanë qenë në ballë të aktiviteteve dhe iniciativave që synojnë arritjen e furnizimeve të sigurta të gjakut përmes dhurimeve të gjakut në mënyrë vullnetare. I gjithë stafi i Albsig iu bashkua nismës për dhurimin e gjakut. Kjo nismë u cilësua si një ndër nismat më të rëndësishme e cila është në mënyrë të drejtpërdrejtë në ndihmë të çdo jete. Stafi i Albsig ishte i gatshëm të jepte kontributin e tij në ndihmë të kauzës “Dhuro gjak, dhuro jetë”. Çdo punonjës në mënyrë vullnetare, pasi mori dakortësinë nga ekipi i mjekëve, bëri të mundur dhënien e kontributit të vlefshëm për shpëtimin e një jete, siç ishte dhurimi vullnetar i gjakut. Dita Botërore e Dhurimit të Gjakut shënohet prej vitit 2004 dhe ka për qëllim dhurimin e gjakut për të shpëtuar jetën e atyre në nevojë. Aktivitetet për këtë ditë bëhen me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për sigurimin e gjakut dhe për të shprehur falenderime për të gjithë ata që dhurojnë gjak për të shpëtuar jetë. Gjaku, përveçse një përbërës i rëndësishëm i trupit tonë, është edhe një lëndë kuruese që nuk mund të prodhohet nga industria farmaceutike, ndaj i vetmi burim i tij është dhurimi nga njerëzit me vullnet të mirë në mënyrë të herëpashershme dhe pa pagesë. Nevojat për gjak janë shumë të mëdha, pasi transfuzioni i gjakut apo përbërësve të tij shërben shpesh për t’i shpëtuar jetën dikujt që pëson aksident apo ndërhyrje kirurgjikale. Fushata e këtij viti përqendrohet tek ata pacientë, të cilëve do u duhen transfuzione gjaku përgjatë gjithë jetës. Autoritetet shëndetësore theksojnë rëndësinë e dhurimit të gjakut në mënyrë të rregullt për të krijuar një rezervë të vazhdueshme gjaku, në mënyrë që pacientët në nevojë të mund ta marrin atëherë kur do të kenë nevojë. Nevojat për gjak në stinën e verës rriten, për këtë arsye apeli i të gjitha institucioneve shëndetësore është për më shumë dhurime vullnetare në ndihmë të fëmijëve talasemikë dhe të gjithë atyre që kanë nevojë për gjak. 14 Qershori njihet si Dita Botërore e Dhurimit Vullnetar të Gjakut. Slogani i këtij viti është: “Dhuro gjak, dhuro jetë, dhuro plazmë, dhuro shpesh”. Bashkëpunimi i përbashkët është qenësor për një jetë më të mirë në shoqëritë ku ne përkasim, ndërsa dhurimi i gjakut është shembulli më i mirë se si bashkëpunimi i mirë e ndihmon jetën. Prandaj, të gjithë ne, me aq sa kemi mundësi, të dhurojmë gjak të paktën një herë në vit, sepse me çdo dhurim tonin, ne shpëtojmë jetë. Albsig, vlerat që na bashkojnë e na bëjnë më të fortë e më të ndërgjegjshëm në çdo aspekt jetësor.





☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL